



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE  
SENATI AKADEMIK**

**VENDIM**

Nr. 5, datë 05.03.2020

**PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË  
ZGJEDHJEVE (KIZ) NË AKADEMINË E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

Senati Akademik i Akademisë së Studimeve Albanologjike i mbledhur sot në datë 05/03/2020, mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, nenin 36, 37 (Senati Akademik), nenin 38 (Funkcionet e Senatit Akademik), e nenin 131, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike", pasi diskutoi për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të KIZ, në zbatimin e nenit 6 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike":

**VENDOSI**

1. Zgjedhjen me votim të fshehtë të 6 (gjashtë) anëtarëve të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), në Akademinë e Studimeve Albanologjike, si më poshtë vijon:
  - a) Ergys Hasa, Instituti i Arkeologjisë
  - b) Hasan Bello, Instituti i Historisë
  - c) Ervin Kaçi, Instituti i IAKSA
  - d) Erjena Cenka, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë
  - e) Albana Mema, Instituti i Historisë
  - f) Anila Shorri, studente
2. Caktimin e sekretarit të KIZ,  
Znj. Albana Mema
3. Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) i Akademisë së Studimeve Albanologjike, në zbatim të kërkesave të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike", të marrë masat e nevojshme për miradministrimin e procesit zgjedhor në Akademinë e Studimeve Albanologjike;

4.Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Akademisë së Studimeve Albanologjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**AKADEMIK PROF. DR. MARENGLER VERLI**

